



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:180410  
Datë: 17.04.2024  
Numri i dokumentit: 05604292

**C.nr.1651/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.D. nga fshati R., Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson Eleonora Ndrecaj- Berisha, avokate nga Prishtina, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "SIGMA", me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 3750 euro, në seancën e datës 03.04.2024, mori, ndërsa me datë 17.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditësit E.D. nga fshati R., Komuna Pejë, të parashtruar me datën 18.12.2020, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "SIGMA", me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 3750 euro.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, paditësi E.D. nga fshati R., Komuna Pejë, përmes të autorizuarës së tij, me datë 18.12.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "SIGMA", me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 3750 euro.

Gjykata, me datën 03.04.2024, ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk ka prezantuar paditësi, përkatësisht e autorizuar e tij, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, po ashtu edhe e paditura në seancë nuk ka prezantuar.

Sipas nenit 409 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se "Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit". Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 409 par.1, 387 par.1 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.1651/20, me datë 03.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.